

**PROGRAMI I BARAZISË PËR PARTNERITETIN E  
STREHIMIT NË BRENT (BRENT  
HOUSING PARTNERSHIP)**

**Gusht 2003**

**Azhurnuar në nëntor 2005**

**PËRMBAJTJA**

**PARATHËNIE nga Kryesia e PSB-së**

**HYRJE**

**RRETHANAT E PUNËS SË PSB-së PËR BARAZINË**

**PËRPARËSITË E PSB-së**

**PËRKUSHTIMI I PSB-së NDAJ BARAZISË**

**ÇFARË ËSHTË SUKSESI?**

**SI E KA PËRGATITUR PSB-ja PROGRAMIN E SAJ TË BARAZISË**

**PROGRAMI I BARAZISË**

**SHTOJCA 1 – FUNKSIONET PËRKATËSE TË PSB-së**

**SHTOJCA 2 – PLANI I VEPRIMIT VITI 1**

**SHTOJCA 3 – PLANI I VEPRIMIT VITI 2**

**SHTOJCA 4 – QIRAMARRJET E PSB-së SIPAS MOSHËS &  
ORIGJINËS ETNIKE**

# **PROGRAMI I HARTUAR I BARAZISË I PARTNERITETIT TË STREHIMIT NË BRENT**

## **PARATHËNIE**

### **Mesazh nga Kryesia e Komisionit të Partneritetit të Strehimit në Brent**

Partneriteti i Strehimit në Brent ka kohë që po punon drejt arritjes së barazisë, por ne e pranojmë që akoma kemi një rrugë të gjatë për të bërë.

Ne e mirëpresim mundësinë që Amendamenti i Ligjit për Marrëdhëniet Raciale siguron për autoritetet publike që të ndërmarrin një rol më aktiv për të përkrahur barazinë raciale. Këtu në Brent, një nga komunitetet më të larmishme në Mbretërinë e Bashkuar, ne jemi të përkushtuar që të përkrahim barazinë për këdo – pavarësisht nga raca, gjinia, paaftësia, mosha ose seksualiteti.

Për ne është e rëndësishme që të ruajmë dhe të zhvillojmë besimin dhe përkrahjen midis të gjitha komuniteteve, që e bëjnë Brent-in një vend kaq interesant dhe të gjallërishëm për të jetuar dhe punuar.

Ne besojmë se kemi një rol kryesor për të luajtur në përkrahjen e barazisë si punëdhënës dhe si sigures shërbimi. Barazia e mundësive për komunitetin dhe forcën tonë të punës mbështet gjithçka që bëjmë ne.

Është punuar shumë që të arrijmë deri këtu. Ne besojmë që procesi i përkrahjes së barazisë në Brent duhet të jetë i vazhdueshëm dhe duhet ndërmarrë në partneritet me të gjithë komunitetet tona. Ne jemi të përkushtuar që pjesën tonë ta çojmë deri në fund. Programi ynë i barazisë përcakton mënyrën që propozojmë ta bëjmë këtë.

### **Kryesia e Komisionit të Partneritetit të Strehimit në Brent**

## **HYRJE**

Ligji (Amendament) i Marrëdhënieve Raciale 2000 (RRAA) ishte përgjigja legislative ndaj konkluzioneve të Hetimit të Stephen Lawrence. RRAA-ja, e cila hyri në fuqi në prill 2001, vendosi një detyrë të përgjithshme mbi të gjitha autoritetet publike që të kenë një konsideratë të përshtatshme ndaj nevojës për të:

- Eliminuar diskriminimin e paligjshëm
- Përkrahur barazinë e mundësive
- Përkrahur marrëdhëniet e mira raciale midis njerëzve nga grupe të ndryshme raciale.

Në mënyrë që të zbatohet këtë detyrë të përgjithshme, çdo autoritet publik duhet të përmbushë dy detyra të veçanta. Këto janë:

- Të përgatitet dhe publikohet Programi i Barazisë Raciale (RES)
- Të vëzhgohen procedurat dhe praktika e punësimit të autoritetit.

Partneriteti i Strehimit në Brent (PSB) nuk është një autoritet publik, siç i përcakton RRAA-ja, dhe nuk e ka të detyruar me ligj të përpilojë Programin e Barazisë Raciale.

Sidoqoftë, PSB-ja e konsideron të vlefshme që të përgatisë një program të tillë, së bashku me përkushtimin e saj të përgjithshëm për të përkrahur barazinë. PSB-ja ka vendosur që programi i saj do të mbulojë përkrahjen e të gjitha çështjeve të barazisë, në vend të përqendrimit në çështjet e barazisë raciale, siç kërkohet nga RRAA-ja. Kjo përqasje në një shkallë më të gjerë për të përkrahur barazinë, pasqyron mënyrën në bazë të së cilës një numër autoritetesh publike kanë përmbushur detyrat e tyre sipas RRAA-së, kur kanë përgatitur Programet e tyre të Barazisë Raciale.

Komisioni për Barazi Raciale, Komisioni për Mundësi të Barabarta, Komisioni për të Drejtat e të Paaftëve, Organizata e Punëdhënësve për qeverinë lokale, së bashku me ndihmën e Komisionit të Revizionimit kanë bashkëpunuar për të përgatitur Standardin e Barazisë për qeverinë lokale, si një strukturë për të trajtuar barazinë për racat, gjininë dhe paaftësinë. PSB-ja po punon që të ndjekë udhëzimet e përcaktuara në Standardin e Barazisë.

## **RRETHANAT E PUNËS SË PSB-së PËR BARAZINË**

PSB-ja është një Organizatë me Administrim të Pavarur (ALMO) që është krijuar në tetor 2002. Ajo administron mbi 10,000 prona në emër të Këshillit të Brent-it dhe siguron shërbime për më tepër se 3000 qiramarrës që i blenë banesat e tyre në bazë të legjislacionit të së Drejtës për të Blerë.

Regjistrimi i popullsisë në 2001 konfirmon shumëllojshmërinë e popullatës në Brent; Brent ka 54.7% popullsi të zezë dhe të pakicës kombëtare, në krahasim me një mesatare 8.7% në të gjithë Anglinë & Uellsin. Vetëm 1 autoritet ka një popullatë më të shumëllojshme. Popullsia e bardhë në Brent përfshin komunitetin Irlandez më të madh në Angli & Uells (6.9% në krahasim me mesataren në shkallë kombëtare prej 1.2%). 8.4% e popullsisë në Brent ka lindur në komunitetin Evropian, duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën, në krahasim me mesataren kombëtare prej 2.3%, dhe Brent ka pjesën më të madhe të banorëve që kanë lindur jashtë Komunitetit Evropian prej 38.2% krahasuar me 6.6% në shkallë kombëtare.

PSB-ja punëson rreth 180 punonjës, prej të cilëve 60% janë femra dhe 40% meshkuj, 68% me origjinë të zezë ose të pakicës kombëtare dhe 30% janë të bardhë.

### **PËRPARËSITË E PSB-së**

Përparësitë e PSB-së janë të lidhura me objektivat e caktuara të qeverisë që duhet t'i përmbushim. Përparësia e parë dhe më e rëndësishmja është që të gjitha shtëpitë tona të arrijnë standardin 'e përshtatshëm' të qeverisë.

Përparësitë tona të tjera kryesore janë të:

- Mbledhim 96.75% të qirasë që duhet të na paguhet
- Zvogëlojmë në 30 ditë kohën që na merr për të ri-lëshuar një banesë me qira, e cila ka nevojë për riparime të vogla.
- Zvogëlojmë humbjen e qirasë, si rezultat i banesave tona që qëndrojnë të boshatisura për shkak të 1.1% të qirasë që nuk na është shlyer.
- Përfundojmë 99% të të gjitha riparimeve përkatëse brenda kohës objektive të përcaktuar nga qeveria.
- Të mbajmë numrin mesatar të ditëve për të përfunduar riparimet jo-urgjente në më pak se 10 ditë (objektivi i qeverisë është 11 ditë)
- Të rrisim nivelin e përgjithshëm të kënaqësisë së qiramarrësve tanë për shërbimet tona në 85% dhe të sigurojmë që qiramarrësit tanë të zinj dhe të pakicës kombëtare të mos mbeten më pak të kënaqur në krahasim me qiramarrësit tanë të bardhë.
- Të realizojmë objektivat e qeverisë, që mbulojnë barazinë në përgjithësi dhe trajtojnë ngacmimin në veçanti.
- Rrisim në 95% numrin e riparimeve përgjegjëse, për të cilat është lënë një takim dhe ky takim është mbajtur.

Ne do të përdorim sistemet tona të mbledhjes së të dhënave dhe të vëzhgimeve, së bashku me metoda të tjera që planifikojmë t'i përdorim për t'i paraqitur në Programin e Barazisë më poshtë, për të siguruar që mënyrat e zbatimit të këtyre përparësive nuk ndikojnë negativisht në mundësitë e disponueshme për një grup, në krahasim me një grup tjetër.

### **PËRKUSHTIMI I PSB-së NDAJ BARAZISË**

PSB-ja ka përshtatur deklaratën e saj të Linjës së Veprimit të Mundësive të Barabarta (EOP), që mbulon rolet e saj si një siguroese e shërbimeve, një punëdhënëse dhe një drejtuese për opinionin publik lokal. Thuhet:

"PSB-ja është përkushtuar të sigurojë që shërbimet që sigurojmë përshtaten me nevojat e të gjithë seksioneve të komunitetit dhe që forca jonë e punës përfaqëson njerëzit që i shërbejmë."

EOP-ja zgjerohet më thellë në këtë përkushtim bazë duke thënë:

- Ne kemi për qëllim të sigurojmë që çdokush ka mundësi të barabartë për të përdorur shërbimet tona.
- Ne i identifikojmë shërbimet që të jenë të përshtatshme, përgjegjëse dhe të ndjeshme.
- Ne kemi për qëllim të sigurojmë që sipërmarrësit tanë dhe të tjerët që kryejnë shërbimet tona të ndajnë gjithashtu vizonin dhe vlerat tona.

- Ne pranojmë që të rekrutojmë, zhvillojmë dhe mbajmë njerëzit më të talentuar duke vlerësuar aftësitë dhe përvojat e ndryshme që ata sjellin në PSB... dhe duke inkurajuar një kulturë të sinqertë dhe të hapur, e cila vlerëson ndryshimet midis nesh, dhe
- Ne jemi të vetëdijshëm për rolin drejtues të rëndësishëm që kemi, për të përkrahur dhe inkurajuar tolerancën, drejtësinë dhe barazinë.

Përveç këtyre përkushtimeve, Këshilli i Brent-it, me të cilin PSB-ja ka kontratë për të siguruar shërbimet e administrimit të strehimit, ka parashikime të caktuara për arrijtjen e barazisë nga PSB-ja. Këto parashikime përfshijnë:

- Marrjen në konsideratë të ndërlikimeve të barazisë në të gjitha aspektet e punës së PSB-së gjatë zhvillimit të linjave të veprimit, zbatimit të tyre dhe vëzhgimit të efektshmërisë së tyre.
- Pasqyrimin e komunitetit lokal para nivelit të Komisionit dhe si një punëdhënës.
- Vlerësimin e kënaqësisë dhe përfshirjes së qiramarrësve në bazë të racës, gjinisë dhe paaftësisë, si dhe trajtimin e pikave të pakënaqësisë, aty ku është e nevojshme.
- Dhënien e ndihmesës në punën e shumë-agjencive në Brent, për shembull, në uljen e krimit dhe çështjet e mjedisit.

Në vitin 2003, PSB-ja autorizoi rishikimin e punës së saj për barazinë. Rishikimi gjeti gjëra të mjaftueshme, që tregonin punën e mirë të PSB-së në sigurimin e shërbimit dhe në punësim. Theksoi gjithashtu disa pika ku kishte nevojë për përmirësime. Këto pika përparësie që duhen përmirësuar janë ndërthurur në Planin e Veprimit që i është bashkëngjitur Programit të Barazisë.

### **ÇFARË ËSHTË SUKSESI?**

Është e rëndësishme të identifikojmë synimet që duam të arrijmë në zhvillimin e Programit tonë të Barazisë. Ne jemi në dijeni që ngandonjëherë është e lehtë që, kur futesh në një proces të tillë të ndërlikuar, të humbasësh pamjen e rezultatit përfundimtar dhe të përqendrohesh vetëm në vetë procesin. PSB-ja e konsideron suksesin të përfshijë:

- Të gjithë përdoruesit e shërbimit, punonjësit e personelit dhe persona të tjerë të përfshirë, duke pasur parasysh që ata trajtohen me drejtësi dhe barazi.
- Siguri në vetvete dhe besim të përmirësuar të të gjithë njerëzve dhe komuniteteve në PSB.
- Një mundësi për të shfaqur që ne i kemi udhëzuar organizatat e tjera me të cilat punojmë për të rritur vlerësimin e tyre ndaj çështjeve të shumëllojshmërisë.

Ne duhet të jemi në gjendje të tregojmë që kemi bërë zhvillime drejt këtyre masave të suksesit. Ne e konsiderojmë provën e suksesit që të përfshijë:

1. Një paraqitje të qartë me anë të anketave, konsultimeve dhe ankesave që:
  - Të gjithë përdoruesit e shërbimit, personeli, kandidatët dhe persona të tjerë të përfshirë të mendojnë që janë trajtuar me drejtësi dhe barazi.
  - Siguria në vetvete dhe besimi i të gjithë njerëzve dhe komuniteteve në PSB është rritur.

2. Përfaqësimi i grave, personave të paaftë, të zinjve dhe njërëzve të pakicës kombëtare do të rritet në të gjitha nivelet në organizatë, në mënyrë që PSB-ja të pasqyrojë më tepër komunitetet që i shërben.
3. Ne do të kërkojmë të sigurojmë që organizata të tjera, me të cilat punojmë të kenë përshtatur objektiva të ngjashme në lidhje me barazinë dhe t'i zbatojnë ato.

## **SI E KA PËRGATITUR PSB-ja PROGRAMIN E SAJ TË BARAZISË**

Për të përgatitur Programin e saj të Barazisë, PSB-ja ka ndjekur udhëzimet e Komisionit për Barazinë Raciale dhe burime të tjera të praktikës së mirë.

Fillimisht, punonjësit eprorë përgatitën një rrjet vetë-vlerësimi për të identifikuar se ç'ndikim kanë pasur linjat e veprimit dhe funksionet e PSB-së në grupe dhe individë të ndryshëm në komunitet. Ky vlerësim fillestar përfshiu marrjen në konsideratë, nëse funksioni ose linja përkatëse e veprimit duhet të ketë si objektivë eliminimin e diskriminimit të padrejtë; të përkrahë barazinë e mundësive; dhe/ose të përkrahë marrëdhëniet e mira raciale.

Punonjësit eprorë rishikuan gjithashtu, nëse do të ishte e mundur që grupe të ndryshme njerëzish (për shembull, të zinjët dhe pakica kombëtare etnike; gratë; të paaftët; të moshuarit; të rinjtë; meshkujt homoseksualë dhe femrat lezbike) të ndikoheshin drejtpërdrejt, nëpërmjet kryerjes së një funksioni të veçantë ose një linje veprimi.

Vlerësimi i tyre mori gjithashtu në konsideratë, nëse PSB-ja ka aktualisht ndonjë të dhënë në dispozicion për përbërjen e përdoruesve të shërbimit për atë funksion ose linjë veprimi.

Hapi tjetër ishte që nëse kishte ndonjë provë ose arsye për të besuar që linjat e veprimit ose funksionet mund të jenë diskriminuese në mënyrë të padrejtë. Këtu punonjësit kanë kontrolluar që të shikojnë, nëse kishte ndonjë provë ekzistuese të rezultateve diferenciale për grupe të ndryshme. A ka pasur gjithashtu ndonjë dëshmi të shqetësimit të publikut (nga anketat, ankesat, vëzhgimi i sigurimit të shërbimit) që ka ndryshime të rëndësishme në rezultate për disa grupe njerëzish?

Së fundi, procedura e vetë-vlerësimit kërkoi përparësi për të vepruar. Këto përparësi janë përcaktuar në Planet e Veprimit për çdo vit.

Programi i Barazisë i hartuar dhe Plani i Veprimit janë shpërndarë në një shkallë të gjerë për t'u komentuar nga grupet e komunitetit, qiramarrësit dhe banorët. Dokumenti përfundimtar është i disponueshëm për punonjësit në faqen e brendshme të internetit të PSB-së për të bërë komente, si dhe në faqen tonë të jashtme të internetit. Nën-komisioni i Barazisë dhe Shumëllojshmërisë të PSB-së kryen rishikimin e rregullt të përparimit të programit.

## **PROGRAMI I BARAZISË**

Ligji (Amendament) i Marrëdhënieve Raciale kërkon një Program të Barazisë Raciale që të:

- Tregojë funksionet dhe linjat e veprimit që autoriteti i ka vlerësuar që përkojnë me detyrën e përgjithshme për të përkrahur barazinë raciale; dhe
- Të përcaktojnë planifikimin për të zbatuar detyrën duke:

- Vëzhguar linjat e tij të veprimit për ndonjë ndikim të padëshirueshëm në barazinë raciale.
- Vlerësuar dhe këshilluar mbi ndikimin e mundshëm të linjave të veprimit të propozuara.
- Publikuar rezultatet e vlerësimeve të tyre, këshillimit dhe vëzhgimit.
- Siguruar që publiku të mund të përdorë informatat dhe shërbimet, dhe
- Përgatitur punonjësit e tij në detyra të përgjithshme.

Ne e kemi përdorur këtë si bazë për Programin tonë të barazisë. Kemi kaluar gjithashtu përtej këtij udhëzimi në një ose dy raste. (Shikoni më poshtë 'Përkushtimet e mëtejshme' për detaje të tjera).

### **Funksionet përkatëse**

Në seksionin e mëparshëm 'Si e ka përgatitur PSB-ja Programin e saj të Barazisë' ne parashtruan se si vendosëm, se për cilat funksione menduam që përkonin me detyrën për të përkrahur barazinë. Shtojca Një përmban listën e plotë të këtyre funksioneve përkatëse.

### **Vëzhgimi për të vlerësuar ndikimin e padëshirueshëm**

PSB-ja tashmë mbledh të dhëna për paaftësinë, origjinën etnike dhe gjininë e të gjithë familjeve që ristrehojmë. Ne e mbledhim këtë informacion në mënyra të ndryshme, për shembull kur bëjmë anketa, kur i kërkojmë banorëve të plotësojnë disa formularë për të shprehur kënaqësinë e tyre dhe kur njerëzit bëjnë ankesa. Ne e përdorim këtë informacion për të kontrolluar nëse mënyra që i kryejmë gjërat ka ndonjë ndikim të padëshirueshëm në një grup banorësh, në krahasim me një grup tjetër.

Këtë informacion, aktualisht nuk e kemi për të gjithë qiramarrësit dhe qiradhënësit tanë, por planifikojmë që ta marrim sa më shpejt që të mundemi. Kur ta bëjmë këtë, do të thotë që kur të vlerësojmë ndikimin e mundshëm të linjave të reja të veprimit, do të jemi në gjendje të veprojmë në një mënyrë më të plotë.

PSB-ja e vlerëson ndikimin që ka në linjat e saj aktuale të veprimit dhe në mënyra të tjera. Ne i trajtojmë në një mënyrë shumë serioze ankesat nga banorë individualë. Nëse hetimet tona tregojnë që një ankesë është e justifikueshme, atëherë ne do të ndryshojmë ndonjë linjë veprimi ose procedurë, nëse është e nevojshme, në mënyrë që banorët e tjerë të mos vuajnë në të ardhmen.

Ne kërkojmë gjithashtu mendimin e banorëve tanë, kur planifikojmë të prezantojmë një linjë të re veprimi, si dhe për ndikimin që kanë linjat ekzistuese të veprimit. Ne e bëjmë këtë nëpërmjet Komisionit Këshillimor të Banorëve, Komisioneve të Strehimit të Zonës, nëpërmjet shoqatave të qiramarrësve dhe banorëve, dhe nëpërmjet paneleve të veçanta të qiramarrësve që kemi krijuar. Ne do të vazhdojmë t'i përdorim ata për të na ndihmuar që të sigurohemi se linjat aktuale dhe të ardhshme të veprimit janë të përshtatshme për të gjithë.

Përveç kësaj, ne do të kërkojmë mendimet e grupeve përkatëse të komunitetit, shkollave, trusteve shëndetësore, policisë dhe të tjerëve për të na ndihmuar të vlerësojmë ndikimin që mund të ketë një iniciativë e re dhe të vëzhgojmë ndikimin e punës sonë aktuale. Ne besojmë që kjo do të na sigurojë njohuri të mëtejshme që do të jenë të dobishme për PSB-në në rrugën saj për të përkrahur

barazinë. Ne do të krijojmë një listë të plotë postare të të gjitha grupeve dhe organizatave, për të na ndihmuar në këtë proces këshillimi.

### **PSB-ja si një punëdhënës**

Punësimi është një nga funksionet përkatëse të Programit tonë të Barazisë. Ligji Amendament i Marrëdhënieve Raciale përcakton detyra shumë specifike për një punëdhënës të përmasave tona. Këto janë që ne të mbledhim dhe vëzhgojmë të dhëna të origjinës etnike, që mbulojnë se kush ka aplikuar për punët tona, kush i ka zënë këto vende pune dhe si trajtohen ata si punonjës.

Ne tashmë e bëjmë shumë herë këtë. Ne mbledhim dhe vëzhgojmë gjithashtu të dhënat në lidhje me paaftësinë dhe gjininë, si dhe të origjinës etnike. Shtojca Tre jep detaje të punonjësve në detyrë, kur kemi përgatitur Programin e Barazisë. Ne panifikojmë gjithashtu të mbledhim dhe të vëzhgojmë të dhënat që mbulojnë moshën, sepse e dimë që kjo mund të ndikojë në mënyrën e trajtimit të kandidatëve dhe punonjësve.

Ne do të vazhdojmë t'i raportojmë rezultatet e vëzhgimeve tona tek nënkomisioni i Barazisë së PSB-së dhe tek Komisioni kryesor. Ne do të përdorim rezultatet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2001 për të caktuar objektivat fillestare kundrejt të cilave do të bëjmë vlerësimin e punës sonë. Ne do të theksojmë, nëse të dhënat tregojnë që kemi nevojë të bëjmë më tepër për të përkrahur barazinë në rolin tonë si punëdhënës. Për shembull, ne tashmë e dimë se relativisht shumë pak persona të paaftë aplikojnë për punët tona, kështu që ne po shikojmë të gjejmë mënyrat e inkurajimit që kjo gjë të ndodhë.

Përveç kësaj, ne do të vazhdojmë të zhvillojmë hapat që kemi marrë për të qenë një punëdhënës i zgjedhjes, duke siguruar terma dhe kushte të shkëlqyera dhe të përshtatshme.

### **Planifikimet e këshillimit**

PSB-ja përdor disa metoda për t'u konsultuar me punonjësit, qiramarrësit dhe banorët. Seksioni më lart për vëzhgimin përmend disa prej tyre. Përveç kësaj, ne kërkojmë mendimet e qiramarrësve dhe të banorëve nëpërmjet buletineve tona të rregullta, nëpërmjet takimeve dhe nëpërmjet anketave të rregullta. Ne kemi krijuar gjithashtu komisione të veçanta me banorë të paaftë, femra, dhe banorë të zinj dhe të pakicave kombëtare.

Ne përpiqemi të sigurojmë që të japim informata në një formë që të jetë e lehtë për t'u kuptuar nga njerëzit. Ne do t'i përdorim këto metoda për t'u konsultuar me qiramarrësit dhe banorët, për vetë Programin e Barazisë, dhe kur të kryejmë rishikimet tona të vlerësojmë se çfarë kemi bërë për të përkrahur barazinë, dhe se ç'duhet të bëjmë më tepër.

Ne e dimë që disa grupe të banorëve tanë, për shembull të rinjtë, janë të nën-përfaqësuar në planifikimet tona aktuale të këshillimit. Ne po shikojmë të gjejmë mënyra që të inkurajojmë më tepër njerëz nga grupe të nën-përfaqësuar, që ata të thonë mendimin e tyre, në mënyrë që ne të këshillohemi në një shkallë sa më të gjerë që të jetë e mundur. Një nga mënyrat që do ta bëjmë këtë, është që të këshillohemi me grupet e komunitetit dhe organe të tjera të përmendura në seksionin e lartpërmendur të vëzhgimit.

### **Vëzhgimi i rezultateve të punës sonë për të përkrahur barazinë**

PSB-ja aktualisht e publikon punën e saj në një sërë mënyrash të ndryshme. Këto përfshijnë vendosjen e informacionit në faqen tonë të internetit nëpërmjet buletineve, nëpërmjet artikujve në shtypin lokal, nëpërmjet fletëpalosjeve, afishimeve dhe në takimet e qiramarrësve dhe banorëve.

Ne do të vazhdojmë t'i përdorim këto metoda për të publikuar rezultatet e punës sonë në përkrahjen e barazisë. Ne do të punojmë gjithashtu me grupet e komunitetit tonë lokal për të na ndihmuar në publikimin e punës sonë, në mënyrë që më tepër banorë të Brent-it të mësojnë se çfarë po bëjmë.

Plani i Veprimit të Programit të Barazisë mbulon një periudhë tri-vjeçare, duke filluar në shtator 2003. Për secilën nga tri vitet, zbatohet një plan i detajuar veprimi dhe zhvillimi i planeve të veprimit raportohet rregullisht tek nën-komisioni për Barazinë dhe Shumëllojshmërinë i PSB-së.

Zhvillimi i planit të Veprimit të Vitit 1 është përcaktuar në Shtojcën 2. Zhvillimi në vitin 1 është verifikuar nga një vlerësim i pavarur që është bërë nga Rrjeti për Cilësinë e Strehimit (RrCS), i cili nxorri në përfundim se për të realizuar shumë prej pikave specifike të caktuara në Planin e Veprimit të Programit të Barazisë kishte pasur zhvillim të konsiderueshëm, dhe se punonjësit dhe përgjegjësit e PSB-së duhet të lavdëroheshin për punën e bërë në vitin 1. Pikat për veprimet e mëtejshme të ngritura nga raporti i RrCS-së janë raportuar tek nën-komisioni i B&Sh, ku është vëzhguar veprimi pasues. Këto përfshinin zhvillimin e një strukture në kuadër të Vlerësimeve të Ndikimit të Barazisë, duke rezultuar në autorizimin e RrCS-së për të punuar me PSB-në në zhvillimin e një strukture dhe në përgatitjen e drejtuesve kryesorë të PSB-së në dhjetor 2004.

Plani i veprimit të Vitit 2 është bashkangjitur si shtojca 3. Raporti i zhvillimit do të paraqitet para nën-komisionit të B&Sh në mars 2006, bashkë me detajet e veprimeve të rena dakord për Vitin 3.

Një sukses i madh i Programit të Barazisë deri më sot ka qenë rritja e qiramarrjeve në PSB, ku njihet moshë, origjina etnike dhe gjinia. Këto të dhëna janë të rëndësishme për zhvillimin e vëzhgimit të fillimit të shërbimeve dhe për sigurimin e drejtësisë në kyerjen e shërbimit. Raporti i Vlerës më të Mirë në vitin 2003 për PSB-në, vuri re se PSB-ja kishte rritur raportin e qiramarrësve, ku origjina etnike ishte regjistruar nga zero deri në 44% në tre vite, dhe se ishte caktuar një objektivë tjetër për të arritur në 70%. Deri në nëntor 2005, PSB-ja e tejkaloi këtë synim, duke marrë të dhëna të origjinës etnike për 91% të qiramarrjeve, dhe duke marrë të dhëna të origjinës etnike, moshës dhe gjinisë për 89% të të gjithë qiramarrjeve. Tabela që përmbledh qiramarrjet e PSB-së sipas moshës dhe origjinës etnike (klasifikimi i regjistrimit të popullsisë 2001) është bashkëngjitur si Shtojca 4.

### **Duke u siguruar që publiku të ketë mundësi të përdorë informacionet dhe shërbimet**

Banorët e PSB-së midis tyre flasin një shumëllojshmëri gjuhësh të ndryshme. Disa nga banorët tanë kanë dëmtime të shikimit ose të dëgjimit. Banorë të tjerë kanë paaftësi në të mësuar. Shumica e banorëve tanë mund të kenë lëvizje të kufizuara. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në mundësinë e banorëve tanë që të mund të përdorin informacionet dhe shërbimet tona. Ne jemi në dijeni të kësaj në PSB dhe kemi marrë disa masa për të përmirësuar mundësinë e përdorimit.

Shumica e punonjësve flasin rrjedhshëm një sërë gjuhësh të ndryshme dhe heraherës mund të bëjnë punën e një përkthyesi. Ne i kemi përkthyer disa dokumenta të rëndësishme në shtatë gjuhë kryesore që fliten në komunitetin e Brent-it. Ne përdorim gjithashtu një shërbim telefonik që siguron përkthime të menjëhershme, kur nuk kemi një përkthyes në dispozicion. Ne përdorim TypeTalk dhe kemi një shërbim minikom për njerëzit që kanë të dëmtuar dëgjimin. Ne sigurojmë të dhëna në kasetë, në shkrimin Braj, ose me shkronja të mëdha, kur i kërkon dikush. Ne mund të organizojmë gjithashtu që të kemi të pranishëm një person të gjuhës me shenja (BSL), duke na dhënë njoftim dy ditë më parë, nëse është e nevojshme. Të gjitha zyrat tona të strehimit përmbajnë elementë të planifikuar, gjë që e bën më të lehtë të përdoren nga njerëzit me lëvizshmëri të kufizuar. Ne planifikojmë të kontrollojmë vitin tjetër që të gjitha ndërtesat tona të hapura për publikun e përgjithshëm të jenë të përdorshme, në përputhje me detyrat tona, në bazë të Ligjit të Diskriminimit të Paaftësisë, 1995.

Prandaj, ne besojmë se tashmë ne e zbatojmë në një shkallë të gjerë këtë pjesë të kërkesave të Programit të Barazisë. Ne do të vëzhgojmë me kujdes dhe do të këshillojmë banorët tanë për të siguruar që ta mbajmë këtë standard – dhe të bëjmë përmirësimet aty ku mundemi.

### **Përgatitja e punonjësve**

Ne bëjmë ç'është e mundur të rekrutojmë punonjës që kontribuojnë në përkushtimet e PSB-së për të përkrahur barazinë. Ne gjithashtu jemi në dijeni që punonjësit tanë duhet të përgatiten përkatësisht për t'i vendosur në praktikë këto përkushtime. Prandaj, ne po aplikojmë një sërë programesh përgatitore që do t'i shpjegojnë punonjësve se çfarë duhet të bëjnë për të zbatuar detyrën e Programit të Barazisë në përkrahje të barazisë. Këto përfshijnë përgatitjet në vjeshtën e vitit 2003 në shërbim të klientëve të paaftë, të cilën 90% të punonjësve e kanë përfunduar me sukses. Gjithashtu është caktuar një përgatitje për anëtarët e komisionit në dhjetor 2005 dhe për të gjithë punonjësit në mars 2006. Kjo përgatitje do të shtrihet gjithashtu tek kontraktorët nëpërmjet programeve përgatitore të Kujdesit të Klientëve. Përveç kësaj, programet e caktuara përgatitore që kanë të bëjnë me një linjë të veçantë veprimi, do t'i referohen gjithashtu detyrës për përkrahjen e barazisë. Disa shembuj përfshijnë përgatitjen në trajtimin e ngacmimit, trajtimin e mosmarrëveshjeve midis komshinjve dhe në kujdesin efektiv ndaj klientëve.

Ne planifikojmë gjithashtu që të kryejmë një rishikim më sistematik të mundësive të përgatitjes të hapura për punonjësit. Rishikimi do të shikojë se si dëgjojnë punonjësit për mundësitë e përgatitjes, sa e lehtë ka qenë për ta të kryejnë përgatitjen që u nevojitej, dhe sa e dobishme është përgatitja sipas mendimit të tyre. Kjo duhet të ndodhë në Vitin Tre të Programit të Barazisë.

### **Përkushtime të mëtejshme**

#### *Puna në Partneritet*

Përkushtimet tona për mundësitë e barabarta nxjerrin në pah rëndësinë që i kushtojmë duke dhënë shembullin tonë. Prandaj, ne do të kërkojmë që të përkrahim përkushtimet tona ndaj barazisë në punën që bëjmë me organizatat e tjera.

Ne punojmë në partneritet me një sërë organesh ligjore dhe vullnetare. Ato përfshijnë shërbimin shëndetësor, policinë, departamentet e Këshillit të Brent-it, agjenci këshillimi dhe grupe të komunitetit. Ne e kemi ndërtuar tashmë këtë përkushtim për të

përkrahur barazinë në punën tonë në partneritet me aq sa të mundemi. Ne duhet të sigurojmë që e bëjmë këtë me të gjithë partneritetet tona dhe që të vëzhgojmë përparimin.

#### *Lidhja e kontratave*

Ne duhet t'i ndërthurim përkushtimet tona për të përkrahur barazinë kur lidhim kontratë me një furnizues. Shumica e punës sonë tek PSB-ja bëhet për ne nga kontraktorë të jashtëm. Kjo ndryshon duke filluar që tek punimet e mëdha të ndërtimit deri në kontrollin e regjistrimeve tona financiare.

Ne tashmë e bëjmë këtë deri në një farë mase. Për shembull, të gjithë kontraktorët tanë kryesorë duhet të na sigurojnë një kopje të linjës së tyre të veprimit të mundësive të barabarta, para se ne t'i lejojmë ata të japin ofertën për punën e tyre. Këtë do ta shikojmë në më tepër detaje gjatë Vitit Dy të Programit të Barazisë, kur të shikojmë planifikimet tona të furnizimit.

#### *Qeverisja*

PSB-ja qeveriset nga një Komision. Ai përbëhet nga kandidatë të Këshillit të Brent-it, përfaqësues të qiramarrësve dhe banorëve, si dhe nga anëtarë të pavarur. Aktualisht në detyrë ndodhen 16 anëtarë të Komisionit. 11 prej tyre janë meshkuj dhe pesë janë femra. Gjashtë janë të zinj ose me origjinë të pakicës kombëtare etnike.

Komisioni PSB-së ka 18 vende. Gjashtë janë kandidatë të Këshillit të Brent-it, gjashtë janë përfaqësues të qiramarrësve dhe banorëve, dhe gjashtë janë anëtarë të pavarur. Këshilli i emëron këshilltarët në raport me përbërjen politike të Këshillit. Komisionet e Strehimit të Zonës emërojnë gjashtë përfaqësuesit e qiramarrësve dhe banorëve. Anëtarët e pavarur rekrutohen nga reklamimet në shtypin lokal dhe nëpërmjet kontaktit me organizatat lokale.

Aktualisht gratë, të zinjët dhe njerëzit nga pakicat kombëtare janë të nën-përfaqësuar në Komision. Ne kemi për qëllim që gjatë 2-3 viteve të ardhshme ta bëjmë Komisionin më tepër përfaqësues të komunitetit lokal.

Komisioni është organi që është përfundimisht përgjegjës për gjithçka që ndodh në emër të PSB-së. Ne tashmë kemi bërë diçka, për të siguruar që Komisioni të marrë në konsideratë detyrën tonë për të përkrahur barazinë, duke krijuar nën-komisionin e Barazisë. Ne sigurojmë gjithashtu që Komisioni të marrë raporte të rregullta për përparimin tonë në zbatimin e Programit të Barazisë dhe që anëtarët e Komisionit të jenë të përgatitur përkatësisht. Përveç kësaj, ne do të sigurojmë që strategjia jonë e përgjithshme dhe planet e biznesit i referohen qartë përkushtimeve tona për të përkrahur barazinë. Puna e Komisionit mbulohet në Vitin Dy të Programit të Barazisë.

**FUNKSIONET PËRKATËSE TË PSB-së**

Më poshtë kemi parashtuar funksionet e PSB-së, që kanë lidhje me detyrën tonë për të përkrahur barazinë, të grupuara në bazë të vitit kur do të bëhet rishikimi i funksionit:

**Viti 1**

Riparimet  
E drejta për të blerë  
Burimet njerëzore  
Administrimi i marrëdhënieve në lagje  
Administrimi i qiramarrjes  
Komunikimet  
Furnizimi

**Viti 2**

Pjesëmarrja e banorëve  
Komisioni – strategjia & linja e veprimit  
Shërbimi i klientëve  
Shërbimet e pronave  
Shërbimi i pastrimit të ndërtimit të Brent-it  
Shërbimet për qiradhënësit

**Viti 3**

Mbledhja dhe kthimi i qirasë  
Zhvillimi i administrimit  
Informatika  
Mësimi dhe zhvillimi  
Ankesat  
Punimet e mëdha